

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.166 DATË 16.12.2004, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është ndryshimi i nenit 19 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, duke rritur numrin e komisioneve të përhershme parlamentare nga tetë (8) në njëmbëdhjetë (11). Ky riorganizim është i diktuar nga nevoja për të rritur efektivitetin e Kuvendit si organi më i lartë përfaqësues, ligjvënës dhe mbikëqyrës, si dhe nga kërkesat e reja që burojnë nga procesi i integritit evropian dhe përafrimi i legjislacionit vendas me *acquis* të Bashkimit Evropian (BE).

Objektivat që synohen të arrihen janë:

- Rritja e kapacitetit të Kuvendit për të trajtuar me profesionalizëm fushat e shumta të politikëbërjes dhe të mbikëqyrjes parlamentare.
- Sigurimi i një strukture të përputhshme me kapitujt e negociatave të anëtarësimit në BE, duke ndarë qartazi fushat e përgjegjësisë së komisioneve.
- Përmirësimi i cilësisë së procesit ligjvënës, me fokus në specializimin dhe përqendrimin tematik të deputetëve.
- Rritja e transparencës, llogaridhënies dhe kontrollit parlamentar mbi qeverinë dhe institucionet e tjera publike.

II. PËRPARËSITË E PROJEKTVENDIMIT DHE EFEKTET E PRITSHME

Agjenda e integritit evropian ka arritur në një fazë vendimtare për Republikën e Shqipërisë. Qëllimi strategjik i finalizimit të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian brenda 27 muajve dhe i ratifikimit të vendimit për anëtarësimin në parlamentet e 27 shteteve anëtare përbën një sfidë institucionale që kërkon një përgjigje strukturore të përshtatshme nga ana e institucioneve kombëtare.

Në këtë kontekst, institucionalizimi i një parlamenti që përgjigjet ndaj standardeve dhe kërkesave të procesit të integritit evropian bëhet i domosdoshëm. Tre dekada pas themelimit të sistemit demokratik pluralist, struktura parlamentare e krijuar në vitet e para të tranzicionit nuk është në gjendje të përballojë në mënyrë efikase kompleksitetin e detyrave që burojnë nga procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Vlerësimi analitik i performancës së komisioneve ekzistuese parlamentare ka identifikuar disa problematika strukturore që pengojnë funksionimin optimal të institucionit.

Kompozimi numerikisht i gjerë i anëtarësisë së komisioneve, mobiliteti i lartë i deputetëve midis strukturave të ndryshme parlamentare dhe mungesa e një orientimi të qartë drejt fushave prioritare të integritit europian, kanë rezultuar në një nivel specializimi të pamjaftueshëm dhe një efikasitet të reduktuar në procesin legjislativ dhe mbikëqyrës.

Gjithashtu, emërtesat e komisioneve reflektojnë një organizim që i përket fazave të mëparshme të zhvillimit institucional dhe nuk janë në përputhje me grupimin tematik të kapitujve të negociatave të anëtarësimit. Ky mosharmonizim krijon vështirësi në trajtimin e integruar të materialeve ligjore që lidhen me *acquis* dhe zvogëlon kapacitetin e parlamentit për të kontribuar në mënyrë konstruktive në procesin e negociatave.

Propozimi për ristrukturimin e komisioneve parlamentare synon të adresojë këto mangësi përmes një riorganizimi që vendos në qendër të vëmendjes kërkesat e procesit të integritit europian. Transformimi i strukturës së tetë komisioneve ekzistuese në një sistem prej njëmbëdhjetë komisionesh të specializuara, përfaqëson një përgjigje të nevojshme për të rritur kapacitetet parlamentare në fushat kyçe të negociatave.

Ndryshimi i propozuar sjell këto përparësi:

- Rritje të fokusit tematik për secilin komision, duke ulur ngarkesën e tepërt dhe duke krijuar mundësinë për specializim të deputetëve.
- Shpërndarje më e drejtë e përgjegjësiave ndërmjet shumicës dhe opozitës, duke garantuar përfshirje të balancuar në procesin e mbikëqyrjes parlamentare.
- Përputhje të plotë me kërkesat e procesit të integritit, ku secili komision reflekton kapituj të caktuar të negociatave me Bashkimin Europian.
- Përmirësim i transparencës dhe rritje e besueshmërisë së Kuvendit tek qytetarët përmes një strukture më funksionale dhe më të afërt me modelet evropiane.

Efektet e pritshme lidhen me rritjen e efikasitetit në shqyrtimin e projektakteve, kontrollin më të mirë të zbatimit të ligjeve dhe ushtrimin e mbikëqyrjes parlamentare mbi qeverinë dhe institucionet e tjera publike. Ky ndryshim, përtej aspektit organizativ, pritet të rrisë ndjeshëm cilësinë e vendimmarrjes parlamentare.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Projektvendimi parashikon ndryshimin e neneve 19 dhe 20 të Rregullores së Kuvendit, duke sanksionuar ngritjen e 11 komisioneve të përhershme parlamentare me prioritet të veprimtarisë këto fusha përgjegjësie:

1. Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat do të ketë fushë përgjegjësie çështjet e politikave ekonomike me përqasjen ndaj tregut të përbashkët Europian, Buxhetin e Shtetit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tij, marrëdhëniet e punësimit, lirisë së lëvizjes së punëtorëve, financat publike, privatizimet dhe sistemi bankar.

2. **Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike** do të ketë fushë përgjegjësie Kodet dhe ligjet duke garantuar përputhshmërinë dhe zbatueshmërinë e tyre me standardin European, organizimin e pushtetit gjyqësor dhe raportimin e tij, administratën e pushtetit gjyqësor, administratën publike, shërbimet e pavarura në sistemin e drejtësisë.

3. **Komisioni për Çështjet e Brendshme dhe Mbrojtjen** do të ketë fushë përgjegjësie me fokus çështjet e brendshme, të rendit, organizimin e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare e publike, organizimin e forcave të armatosura dhe bashkëpunimin ushtarak, çështjet e organizimit dhe funksionimit të, pushtetit vendor, emergjencat civile dhe mbrojtja nga fatkeqësitë, shërbimet sekrete.

4. **Komisioni për Edukimin, Shkencën dhe Sportet** do të ketë fushë përgjegjësie arsimin, kërkimin shkencor, inovacionin dhe zhvillimin e sportit.

5. **Komisioni për Shëndetësinë dhe Mirëqenien Sociale** do të ketë fushë përgjegjësie çështjet lidhur me politikat shëndetësore, sigurimet shoqërore, familjen, gruan dhe çështjet mbi mirëqenien sociale.

6. **Komisioni për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm** do të ketë fushë përgjegjësie *çështjet në fushën e energjisë, burimeve natyrore dhe biodiversitetit, infrastrukturën, industrinë dhe telekomunikacionin, rregullimin e territorit, tregtia dhe mbrojtja e mjedisit, dhe çështjet për zhvillimin e qëndrueshëm.*

7. **Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik** do të ketë fushë përgjegjësie çështje në fushën e të drejtave dhe liritë themelore të njeriut, çështjet lidhur me veprimtarinë e mediave audiovizive dhe informimit, çështjet për garantimin e lirisë së shprehjes.

8. **Komisioni për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural** do të ketë fushë përgjegjësie çështjet e bujqësisë, blegtorisë dhe peshkimit, çështjet e zhvillimit rural, çështje të kontrollit dhe garantimit të sigurisë ushqimore, monitorimin e zbatimit të politikave në fushën e bujqësisë dhe të sigurisë ushqimore

9. **Komisioni për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën** do të ketë fushë përgjegjësie çështjet e kulturës kombëtare dhe trashëgimisë kulturore, zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, politikat për ruajtjen e identitetit kulturor, gjuhësor të diasporës dhe të pjesëmarrjes së saj në proceset politike dhe sociale në vend.

10. **Komisioni për Europën dhe Punët e Jashtme** do të ketë fushë përgjegjësie çështjet e integritit europian, përafrimi i legjislacionit me legjislacionin e Bashkimit Europian, mbikëqyrja e zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim- Asociimit, si dhe mbikëqyrja e asistencës financiare të Bashkimit Europian për Shqipërinë, monitorimi i negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Europian, politikat e jashtme

marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, si dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare

11. Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale do të funksionojë si një mekanizëm i ri që adreson çështjen mbi përfshirjen e qytetarëve dhe grupeve të interesit në procesin ligjvënës dhe në hartimin e politikave publike, çështje të bashkëpunimit ndërinstitucional, çështje të mbikëqyrjes institucionale dhe kontrollin e zbatimit të ligjit si dhe forcimin e dialogut ndërinstitucional.

Bazuar në ndryshimet e propozuara, përmbajtja e pikës 3 të nenit 20 është e panevojshme. Për këtë arsye në projektvendim është propozuar shfuqizimi i kësaj pike.